



Datë: 07.07.2025
Numër Protokoll: 4536/2025

A.nr.796/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, -anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.796/2025 të datës 02.05.2025 të parashtruar nga ankuesja S.P, kundër organit të punësimit/Ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*transferim pas ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.07.2025.

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.796/2025 e datës 02..05.2025 e parashtruar nga ankuesja S.P.

II. Anulohet Vendimi Nr.458 i datës 18.03.2025 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, ndërsa lënda kthehet *në rishqyrtim* dhe *rivendosije* tek organi i njëjtë (Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës).

III. Obligohet Komisioni i Ristrukturimit për MMPHI, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në pikën **II** të dispozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi, të përcaktuar si në pikën **III** të dispozitivit të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, S.P (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja*), e cila sipas Akt Emërimit të datës 17.01.2012 është e punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në pozitën Zyrtare për Licenca dhe Leje, me datë 02.05.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.796/2025 dhe protokolluar me numër 2923/2025, kundër Vendimit me Nr.458 i datës

18.03.2025, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik DMZP/MPB, lidhur me transferimin pas ristrukturimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa më datë 13.06.2025, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Tutje, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vepruar sipas kërkesës së Kryetares së Kolegjit të datës 16.06.2025, përmes Vendimit me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 4117/2025 të datës 16.06.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.600/2025, të parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2923/2025 të parashtruar nga ankuesja më datë 02.05.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimin e ankueses; Vendimin me Nr. 458 të datës 18.03.2025; Email i datës 17.04.2025; Akt Emërimi i datës 17.01.2012; Diploma e datës 25.03.2017; Rregullorja Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 28.05.2025; Përgjigje në ankesë e datës 13.06.2025 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtare për Leje dhe Licenca; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar i lartë për transport ujqor; Lista e pagave për muajin janar dhe muajin maj 2025; Vendimi VK/2025 i datës 16.06.2025 i Kryetarit të Këshillit për shtyrje të afatit për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është **e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, gjegjësisht sipas Akt emërimit të datës 17.01.2012, mbanë pozitën e punës *Zyrtare për Licencim dhe Leje*.

Tutje sipas Vendimit me Nr.073/2024 të datës 29.03.2024 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa në kuadër të përgjegjësisve ligjore, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme me Vendimin me Nr.2392/2024, të datës 29.11.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i cili më datë 03.03.2025 ka miratuar Raportin e punës me Nr.191, dhe propozimet lidhur me ristrukturimin për këtë institucion, duke propozuar që ankuesja të risistemohet nga pozita *Zyrtare për Licenc dhe leje-Klasa Profesional 2*, por me emërtim të ndryshuar në atë të *Zyrtar i Lartë për Transport ujqor-Klasa Profesional 1*.

Si rrjedhojë, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 18.03.2025 ka nxjerr Vendimin me Nr.458, për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, me të cilin akt ankuesen nga pozita

aktuale *Zyrtare për leje dhe licenca* e ka ri caktuar në pozitën më të lartë *Zyrtar i lartë për transport ujqor, Profesional 1*.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshill, thekson se përmes Vendimit të lartë theksuar nuk është transferuar në pozitën e njëjtë paraprake, duke pretenduar se Komisioni i Ristrukturimit me këtë rast ka bërë shkelje ligjore, diskriminim dhe pabarazi, sepse sipas saj nga Departamenti për Leje dhe licenca për Transport në piken 3 të nenit 44 të Rregullores Nr.08/2024 për Organizimin e brendshëm dhe të Sistematizimit të Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, numri i punonjësve në Sektorin për Leje dhe Licenca është 10, dhe kërkon që të ndryshohet vendimi për transferim nga pozita Zyrtar i Lartë të trafikut ujqor në pozitën Zyrtar i Lartë për leje dhe licenca.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *1. Nëse për shkak të shuarjes apo rristrukurimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të rristrukuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo rristrukurimi të institucionit krijohet komisioni i rristrukurimit që shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësi përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. 6. Komisioni i rristrukurimit, i parashkuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësi përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në nënparagrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet rristrukurimi përkatës. 7. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton procedura të hollësishme për zbatimin e këtij neni... si dhe Neni 13 të Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: 1. Në rastet e shuarjes apo rristrukurimit të institucionit, DMZP për institucionet e administratës shtetërore, apo NjMBNj për institucionet e tjera, brenda 30 ditëve nga miratimi i aktit të rristrukurimit krijon një komision rristrukurimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, për të cilën ky i fundit i plotëson kërkesat e vendit të punës. 2. Komisioni udhëhiqet nga përfaqësuesi i DMZP-së për institucionet e administratës shtetërore dhe nga përfaqësuesi i NjMBNj-së për institucionet e tjera. 3. Komisioni i Rristrukurimit përbëhet edhe nga dy anëtarë tjerë, të cilët janë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në paragrafin 3 të nenit 12 të kësaj Rregulloreje, sipas rastit ku bëhet rristrukurimi përkatës. 4. Komisioni, brenda dyzetepesë (45) ditëve nga data e themelimit, i propozon me shkrim DMZP-së për institucionet e administratës shtetërore, apo NjMBNj-së për institucionet e tjera, transferimin e nëpunësit siç parashihet në paragrafin 3 të nenit 12 të kësaj Rregulloreje. 5. Komisioni në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve për shkak të rristrukurimit të institucionit mbështetet në përshkrimet e vendeve të lira apo të atyre të krijuara të punës dhe kualifikimet dhe të dhënat e nëpunësve. 6. Vendimi është individual për çdo nëpunës. 7. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve për shkak të rristrukurimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kritere: 7.1. përvojën e nëpunësit në shërbimin civil; 7.2. mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë të nëpunësit për tre (3) vitet e fundit; 7.3. kualifikimet profesionale të nëpunësit; dhe 7.4. trajnimet e nëpunësit. 8. Komisioni i rristrukurimit*

cakton peshën specifike të kritereve të përcaktuara në paragrafin 7 të këtij neni dhe metodologjinë e vlerësimit të secilit kriter.

Kolegji i Këshillit, konstaton se me hyrjen në fuqi të Rregullores (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka pasuar me shuarje të pozitive, ndryshime në emërtime të pozitive përkatëse si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kritereve të punës për pozita të caktuara, ndërsa pozita e ankueses *Zyrtare për leje dhe licenca*, me këtë rregullore është emërtuar *Zyrtare e lartë e trafikut ujqor, klasa Profesional 1*, pranë Departamentit të Transportit, ashtu që duke marrë parasysh se ankuesja ka plotësuar kriteret e posaçme lidhur me arsimimin, përvojën dhe kualifikimet, e njëjta sipas Komisionit të Ristrukturimit është propozuar të risistemohet në pozitën *Zyrtare e lartë e trafikut ujqor, Profesional 1*.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i Përshkrimit të detyrave të punës të pozitës së punës *Zyrtar i Lartë për transport ujqor-Klasa Profesional 1*, ka gjetur se kërkesat e përgjithshme formale dhe specifike, që nëpunësi duhet ti plotësoj për ushtrimin e kësaj pozite janë: *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) e pa specifikuar dhe së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale*, dhe se duke u bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht në Akt emërimin e datës 17.01.2012, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës, përmes të cilit dëshmohet se ankuesja nga data 17.01.2012 ka qenë në pozitën *Zyrtare për leje dhe licenca*.

Andaj, Kolegji i Këshillit në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, vlerëson se Komisioni i Ristrukturimit nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe në këtë mënyrë gabimisht ka zbatuar dispozitat materiale, sepse sipas Kolegjit raporti i komisionit nuk përmbajnë sqarim lidhur me faktet dhe rrethanat që kanë qenë vendimtare në vendimmarrje për ri sistemimin e ankueses në pozitën *Zyrtar i lartë për transport ujqor Aplikime-Klasa Profesional 1*, përkatësisht Komisioni i Ristrukturimit me rastin e propozimit për ri sistemimin e ankueses në pozitën përkatëse, nuk ka evidentuar se a i plotëson saktësisht ankuesja kriteret bazë për pozitën *Zyrtar i Lartë për transport ujqor-Klasa Profesional 1*, apo se cilat kritere nuk i ka plotësuar ankuesja për pozitën e lartpërmendur, respektivisht i njëjti nuk ka arritur ta arsyetojë vendimin se pse ankuesja është risistemuar në këtë pozitë apo se për çfarë arsye ankuesja nuk është avancuar sikurse nëpunësit tjerë, dhe duke u bazuar në nenin 6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *1. Organi publik vepron në pajtim me parimin e barazisë dhe mos diskriminimit. 2. Personat në të njëjtën situatë trajtohen në mënyrë të njëjtë. Dallimi në trajtimin e çështjeve justifikohet vetëm nëse dhe për aq sa ai përputhet me ndryshimet objektive të çështjeve përkatëse. 3. Organi Publik, në mënyrë të veçantë, shmang çdo diskriminim të padrejtë ashtu siç përcaktohet me Ligjin kundër diskriminimit,;* dhe duke qenë se më lartë është konstatuar se edhe ankuesja i plotëson kërkesat e përgjithshme formale dhe specifike për ushtrimin e pozitës së punës *Zyrtare e për transport ujqor-Klasa Profesional 1*, e me qëllim të kthimit të ligjshmërisë dhe trajtimit të barabartë dhe pa diskriminim të nëpunësve civil, Kolegji i Këshillit, vendosi për anulimin e Vendimit me Nr.458 të datës 18.03.2025 për ri sistemimin e ankueses, të veproj sipas nenit 13 paragrafit 7 dhe 8 të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, si dhe dispozitave të Udhëzuesit Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimit pas Ristrukturimit-Shtojca, gjegjësisht të përdor sistemin e pikëzimit, për të gjithë këta nëpunës civil dhe të propozoj sistemimin e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 4 dhe 5 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.796/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses S.P;
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (*Sekretarit të Përgjithshëm, Komisionit të Ristrukturimit dhe Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore*),
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.